



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE

Nr. 5705/1 prot.

Vlorë, më 24.03.2026

PROJEKTVENDIM

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ 2026

**PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË FAMILJEVE DHE INDIVIDËVE QË PËRFITOJNË BANESË ME KOSTO TË ULËT NËPËRMJET KREDIVE ME KUSHTE LEHTËSUESE NGA BUXHETI I SHTETIT.**

Këshilli i Bashkisë Vlorë, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 1 dhe 2, neni 24 pika 1, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, neni 44, 45, 47, 48, 49, të VKM Nr.453 datë 03.07.2019 “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet, që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”, të VKM Nr.268, datë 29.04.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.453, datë 3.7.2019, të Këshillit të Ministrave ” Për masën e subvencionimit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët me kredi të lehtësuar nga shteti”, të VKM Nr.384 datë 12/06/2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, të VKM Nr.301, datë 15.04.2020 “Për normat e strehimit, si edhe kushtet e standartet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët”, të shkresës Nr.15406 Prot., datë 06.12.2024 “Mbi programin për subvencionin e interesave të kredisë” dhe Nr.6859prot., datë 21.05.2025 “Mbi nivelin e të ardhurave maksimale për të përfituar nga programi i subvencionimit të interesave të kredisë” të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike dhe Vendimin e Komisionit të Strehimit të Bashkisë Vlorë,

**VENDOSI**

- I. Të miratojë listën emërore të familjeve dhe individëve që përfitojnë banesë me kosto të ulët nëpërmjet kredive me kushte lehtësuese nga buxheti i shtetit, emrat sipas tabelës bashkëlidhur pjesë përbërëse e këtij projektvendimi.
- II. Efektet financiare sipas pikës I. do të mbulohen nga buxheti i shtetit nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit në fondet për programet e strehimit social.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Infrastrukturës & Investimeve Publike, Enti Kombëtar i Banesave, si edhe institucionet financiare të përzgjedhura nga ministria që financon programin.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015, neni 55, pika 6.

  
KRYETAR  
Brunjlda Mersini

Tabela nr.1

LISTA EMËRORE E FAMILJEVE/INDIVIDËVE TË KUALIFIKUAR NGA KOMISIONI I STREHIMIT PËR  
MIRATIM NGA KËSHILLI I BASHKISË VLORË  
KREDI ME KUSHTE LEHTËSUJSE VITI 2026

Nr. ren.	Emri / Atësia / Mbiemri	Përbërja familjare numri personave	Struktura e apartamentit që përfiton	Kushtet e strehimit neni 16 gërma (a)	Kushtet familjare neni16 gërma (b)	Kushtet sociale neni 16 gërma (c)	Të ardhurat mujore neto të familjes	Punësimi	Kufiri maksimal i kreditimit që përfiton
1	Arben Petrit Braho	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi	familje e re		102222	në shtet	5,563,080
2	Anisa Haxhi Bregaj	2	1+1	nuk disp.ban.pronësi	Vajza-nëna		74686	në shtet	3,777,400
3	Astrit Selim Duka	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi	familje e re		88583	në privat	5,563,080
4	Ambra Arben Muhametaj	1	garsonierë	nuk disp.ban.pronësi	l ri ≤ 40 vjeç		45785	në privat	3,090,600
5	Arbër Romeo Çuni	2	1+1	nuk disp.ban.pronësi	l ri ≤ 40 vjeç		60213	në shtet	3,777,400
6	Arben Çerçiz Çerçizi	5	3+1	nuk disp.ban.pronësi		fam.kom.egjipt.	66825	në privat	6,868,000
7	Erida Pavlo Naço	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi	familje e re		37740	në privat	5,563,080
8	Enerik Besnik Rrapaj	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi	familje e re		71097	në shtet	5,563,080
9	Ervis Josif Piro	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi			111572	në shtet	5,563,080
10	Erisa Mitat Katija	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi			76771	në shtet	5,563,080
11	Edmond Ali Aliaj	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi	familje e re		78044	në privat	5,563,080
12	Ermal Dalip Beqiri	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi			94940	në shtet	5,563,080
13	Fabjola Bedri Malkaj	3	2+1	nuk disp.ban.pronësi	familje e re		77364	në privat	5,563,080
14	Griselda Shefqet Veizaj	1	garsonierë	nuk disp.ban.pronësi	l ri ≤ 40 vjeç		42063	në privat	3,090,600
15	Griselda Besnik Hoxhaj	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi	familje e re		46699	në privat	3,777,400
16	Gentjan Dalip Beqiri	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi	familje e re		81743	në privat	5,563,080
17	Gazment Qazim Tarba	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi			74740	në privat	5,563,080
18	Jorida Faslli Meta	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi	familje e re		47928	në privat	5,563,080
19	Klaudjo Aleksandër Begaj	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi	familje e re		112343	në privat	5,563,080
20	Loshjan Gëzim Krasniqi	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi			116115	në privat	5,563,080
21	Marsida Ëngjëll Rrapaj	1	garsonierë	nuk disp.ban.pronësi	l ri ≤ 40 vjeç		46148	në shtet	3,090,600
22	Marjona Agron Çaçi	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi			46754	në shtet	5,563,080
23	Marinela Petrit Velaj	1	garsonierë	nuk disp.ban.pronësi	l ri ≤ 40 vjeç		37329	në privat	3,090,600
24	Pranvera Bilbil Mehmeti	2	1+1	nuk disp.ban.pronësi	Vajza-nëna		68245	në shtet	3,777,400

25	Rakip Bujar Haxhiu	1	garsonierë	nuk disp.ban.pronësi	l ri ≤ 40 vjeç		37060	në privat	3,090,600
26	Safet Buran Kasëmi	3	2+1	nuk disp.ban.pronësi	familje e re		86443	vetëpunës.	5,563,080
27	Sidorela Maranaj Kadriaj	3	1+1	nuk disp.ban.pronësi	familje e re		63068	në privat	3,777,400
28	Tereza Esheref Krekaj	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi	familje e re		96708	në privat	5,563,080
29	Valentina Jakup Çelaj	1	garsonierë	nuk disp.ban.pronësi			55758	në shtet	3,090,600
30	Valbona Thanas Baka	3	2+1	nuk disp.ban.pronësi	familje njëprind.		62160	në privat	5,563,080
31	Xhensila Minella Bucaj	2	1+1	nuk disp.ban.pronësi	familje e re		69208	në shtet	3,777,400
32	Xhafer Eqerem Canaj	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi			102172	në privat	5,563,080
33	Ardit Agron Likaj	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi	familje e re		104842	në privat	5,563,080
34	Çerçis Abedin Caushaj	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi	familje e re		89056		5,563,080
35	Diljana Arben Isufi	3	2+1	nuk disp.ban.pronësi	familje e re		81954	në privat	5,563,080
36	Daniela Kamber Minga	3	2+1	nuk disp.ban.pronësi	familje njëprind.		50950	në privat	5,563,080
37	Dorina Bajram Tahiri	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi			86580	në privat	5,563,080
38	Eri Luan Nazaj	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi	familje e re		47629	në privat	5,563,080
39	Ervista Tasim Përrallaj	2	1+1	nuk disp.ban.pronësi	familje njëprind.		42180	në privat	3,777,400
40	Eglantina Riza Shehu	2	1+1	nuk disp.ban.pronësi	familje njëprind.		53783	në privat	5,563,080
41	Elida Toli Londi	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi			49222	në privat	5,563,080
42	Esmeralda Kastriot Hajdinaj	5	3+1	nuk disp.ban.pronësi			88689	në shtet	6,868,000
43	Ermal Bilal Xheka	5	3+1	nuk disp.ban.pronësi	familje e re		129403	në shtet	6,868,000
44	Elda Skënder Dalipi	2	1+1	nuk disp.ban.pronësi	familje njëprind.		47654	në shtet	3,777,400
45	Françeska Festim Elezi	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi	familje e re		111103	vetëpunës.	3,777,400
46	Florida Sali Nuredini	2	1+1	nuk disp.ban.pronësi	Vajza-nëna		35520	në privat	5,563,080
47	Kristjana Pajtim Merkaç	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi	familje e re		49728	në privat	5,563,080
48	Kristi Qemal Rrapaj ?	1	garsonierë	nuk disp.ban.pronësi	l ri ≤ 40 vjeç		38782	në privat	3,090,600
49	Marildo Ismail Hodaj	3	1+1	nuk disp.ban.pronësi	familje e re		74580	në privat	3,777,400
50	Romina Fatmir Abazaj	2	1+1	nuk disp.ban.pronësi	familje njëprind.		38880	në privat	3,777,400
51	Redon Resmi Mustafaraj	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi	familje e re		54000	në privat	5,563,080
52	Stela Shyqyri Gockaj	2	1+1	nuk disp.ban.pronësi	Vajza-nëna		48135	në privat	3,777,400
53	Sidorela Nimet Skëndaj	2	1+1	nuk disp.ban.pronësi	Vajza-nëna		64101	në shtet	3,777,400
54	Suela Hodo Xhemalaj	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi	Vajza-nëna		95978	vetëpunës.	5,563,080
55	Ardit Sejdi Agaraj	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi	familje e re		95066	në shtet	5,563,080
56	Anisa Foto Prenci	3	2+1	nuk disp.ban.pronësi			90586	në shtet	5,563,080
57	Drilon Dero Ademaj	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi	familje e re		46557	në privat	5,563,080
58	Inida Agim Dalipi	5	3+1	nuk disp.ban.pronësi			66430	në privat	6,868,000

59	Marjana Bardhosh Llanaj	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi	Vajza-nëna		73702	në shtet	5,563,080
60	Oligerta Bardhyl Perrallaj	3	2+1	nuk disp.ban.pronësi	familje njëprind.		93372	në shtet	5,563,080
61	Shqiponja Lefter Lato	3	2+1	nuk disp.ban.pronësi	familje njëprind.		90668	vetëpunës.	5,563,080
62	Eliana Syrja Begaj	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi			55561	në shtet	5,563,080
63	Erjon Vilson Beqiraj	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi	familje e re		58184	në privat	5,563,080
64	Bardhosh Hektor Troka	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi	familje e re		47402	në shtet	5,563,080
65	Ajet Piro Llanaj	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi			103157	në privat	5,563,080
66	Klementina Novrus Pashaj	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi			78254	në shtet	5,563,080
67	Ana Vasillaq Gjokoli	4	2+1	nuk disp.ban.pronësi	familje e re			në privat	5,563,080



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË  
DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 5708/1 prot.

Vlorë, më 24.03.2026

**RELACION**  
**Për projekt-vendimin**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË FAMILJEVE DHE INDIVIDËVE QË PËRFITOJNË BANESË ME KOSTO TË ULËT NËPËRMJET KREDIVE ME KUSHTE LEHTËSUESE NGA BUXHETI I SHTETIT.**

Me anë të shkresës Nr.15406 prot., datë 06.12.2024 “Mbi programin për subvencionin e interesave të kredisë”, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, ka njoftuar njësitë e vetëqeverisjes vendore se në zbatim të VKM Nr.453, datë 03.07.2019 “Për masën e subvencionimit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët me kredi të lehtësuara nga shteti” të ndryshuar, ka planifikuar fondet e nevojshme për trajtimin me strehim të familjeve që përfitojnë banesë me kosto të ulët nëpërmjet kredive hipotekore me interes 3% në vit, që të aplikojnë sipas ligjit 22/2018, datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, duke akorduar 68 kuota të reja shtesë për Bashkinë Vlorë. Në total, bashkë me kuotat e mbartura, Bashkia Vlorë ka në dispozicion 134 kuota të kredisë së butë për të vijuar me procedurat e miratimit të familjeve përfituese krahasimisht me plotësimin e kritereve ligjore.

Këshilli i Bashkisë Vlorë me Vendimin Nr.3, datë 10.01.2025 “Për miratimin e zbatimit të programit të banesave me kosto të ulët nëpërmjet kredive me kushte lehtësuese nga buxheti i shtetit, miratimin e sistemit të pikëzimit, nivelin minimal dhe maksimal të të ardhurave dhe dokumentacionin që duhet të plotësojnë familjet dhe individët që përfitojnë nga ky program” i ka hapur rrugën shpalljes së njoftimit publik për fillimin e aplikimeve për qytetarët e interesuar që plotësojnë kushtet e përfitimit nga ky program. Procedurat e aplikimit, të përzgjedhjes dhe të miratimit janë bazuar në Urdhërin e Brendshëm Nr.245, datë 23.06.2025, të ndryshuar të Kryetarit të Bashkisë Vlorë “Për përcaktimin e procedurave, afateve, dokumentacionit dhe niveleve të të ardhurave të nevojshme për përzgjedhjen dhe miratimin e familjeve/individëve që do të përfitojnë nga programi i kredive të lehtësuara nga shteti”. Nivelet, apo kufinj të të ardhurave që duhet të plotësojnë subjektet përfituese janë përcaktuar referuar shkresës Nr.6859prot., datë 21.05.2025 “Mbi nivelin e të ardhurave maksimale për të përfituar nga programi i subvencionimit të interesave të kredisë” të Ministrisë së Ekonomisë dhe Informacionit. Komisioni i Strehimit të Bashkisë Vlorë i ngritur me Urdhërin e Brendshëm Nr.415, datë 18.08.2025 “Për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Strehimit të Bashkisë Vlorë” të ndryshuar, ka bërë vlerësimin e kërkesave dhe të dokumentacionit në të gjitha fazat e aplikimeve, duke marrë vendimet përkatëse. Për çdo vendim të këtij komisioni është bërë shpallja publike për njoftim të familjeve mbi kualifikimin dhe skualifikimin. Familjet/individët e kualifikuar kanë vijuar me fazën e rradhës dhe vlerësimin e rradhës. Konkretisht,

1.Faza e parë e aplikimeve është bërë në datat 1-31 korrik 2025, ku të gjithë të interesuarit kanë aplikuar në portalin e-albania dhe kanë depozituar pranë Bashkisë Vlorë formularin e kërkesës për të përfitur kredi me kushte lehtësuese nga shteti, në total 181 familje dhe individë.

Komisioni i Strehimit me Vendimin Nr.8, datë 20.08.2025 “Për shqyrtimin e formularëve të kërkesave të regjistruara pranë Bashkisë Vlorë nga familjet dhe individët që kanë aplikuar në portalin e-albania për të përfitur kredi me kushte lehtësuese nga buxheti i shtetit për vitin 2025” shqyrtoi formularët e depozituar pranë Bashkisë Vlorë, të plotësuar dhe të shkarkuar nga portali e-albania në sistemin online të strehimit, 181 formularë.

Ndërkaq një numër familjesh dhe individësh në datat 1-31 korrik 2025 kanë aplikuar në portalin e-albania, kanë plotësuar formularin e kërkesës, por nuk e kanë shkarkuar për ta depozituar fizikisht pranë Bashkisë Vlorë. Nëpërmjet sistemit online të strehimit në e-albania nga specialistja e strehimit janë printuar këto kërkesa, në total 82. Komisioni i Strehimit të Bashkisë Vlorë me Vendimin Nr.9, datë 08.09.2025 “Për shqyrtimin e formularëve të kërkesave të familjeve dhe individëve që kanë aplikuar në portalin e-albania për të përfitur kredi me kushte lehtësuese nga buxheti i shtetit për vitin 2025 dhe nuk janë depozituar fizikisht pranë Bashkisë Vlorë” ka bërë përzgjedhjen dhe kualifikimin e formularëve në total  $181+82=263$  aplikime. Me njoftimin publik të datës 23.09.2025 janë shpallur listat paraprake të fazës së parë që janë kualifikuar për të përfitur nga programi social “Kredi me kushte lehtësuese nga shteti”, 168 emra sipas Aneksit Nr.1 dhe listat e familjeve/individëve që skualifikohen në fazën e parë paraprake, 95 emra sipas Aneksit Nr.2. Familjeve/individëve të skualifikuar në këtë fazë u është caktuar 10 ditë afat për të ankimuar vendimin e komisionit. Në përfundim të këtij afati me Vendimin Nr.10, datë 15.10.2025 “Për shqyrtimin e ankesave të familjeve dhe individëve që nuk janë kualifikuar në fazën e parë për të përfitur kredi me kushte lehtësuese nga buxheti i shtetit për vitin 2025 dhe miratimin e listës përfundimtare të personave që kualifikohen në këtë fazë”, Komisioni i Strehimit miratoi listën përfundimtare të familjeve/individëve që kualifikohen në fazën e parë, në total 174. Këto familje kanë vazhduar me fazën e dytë të aplikimit, përgatitjen dhe depozitimin e dokumentacionit të përcaktuar sipas njoftimit në shpalljen publike. Mbështetur në “Deklaratën personale të aplikuesit” bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e formularit të aplikimit “Kërkesë për të përfitur nga programet e strehimit social” nëpërmjet e-albania, për të ardhur në ndihmë të qytetarëve, me qëllim minimizimin e kostove financiare dhe kursimin e kohës, Bashkia Vlorë ka marrë përsipër të sigurojë dokumentacionin e përgjithshëm, duke lënë për qytetarët të sigurojnë dokumentacionin individual. Afati i aplikimit për qytetarët kanë qenë datat 23/10/2025 deri në 23/11/2025. Ndërkohë nga Bashkia Vlorë është dërguar lista emërore dhe numri i identifikimit në institucionet, ASHK, për pronat që mund disponohen në emër të secilit anëtar të familjes, apo kanë kryer transaksion 5-vitet e fundit, në Drejtoria Rajonale Tatimore, për personat që mund të figurojnë të regjistruar pranë kësaj drejtorie, Agjensia Kombëtare e Punësimit për personat që trajtohen me pagesat e papunësisë, si edhe Njësitë Administrative për personat që janë banorë në territorin administrativ që mbulojnë.

Në përfundim të kësaj faze dokumentacioni i depozituar nga qytetarët dhe informacioni i siguruar nga institucionet u vlerësuan nga Komisioni i Strehimit i mbledhur në datat 14 dhe 15/01/2026. U konstatua se deri në këtë datë kishin paraqitur dokumentacionin 129 familje/individë që rezultojnë kualifikues nga faza e parë. Nga këto komisioni mori në shqyrtim 127 dosje dhe vendosi:

1. Të kualifikojë familjet/individët, për të cilët rezultojnë se nuk disponojnë pasuri në pronësi në emër të secilit anëtar të familjes dhe nuk kanë kryer transaksion për tjetërsimin e pronësisë të paktën 5 vitet e fundit.
2. Të kualifikojë familjet/individët për të cilët, të ardhurat mesatare mujore për periudhën 1 -vjeçare korrik 2024-qershor 2025, rezultojnë brenda niveleve të të ardhurave të përcaktuara për këtë program.
3. Të skualifikojë familjet/individët, të cilët rezultojnë me të ardhura mbi nivelin maksimal të të ardhurave të përcaktuara, që përbën kriter skualifikimi.
4. Të skualifikojë familjet/individët, të cilët rezultojnë me të ardhura nën nivelin minimal të përcaktuar si nivel referues, pasi nuk përmbushin kriterin e përballueshmërisë.
5. Individët/ Familjet që nuk janë shpallur përfitues në këtë fazë, do të kenë të drejtën e ankimimit administrativ pranë Bashkisë Vlorë, brenda një afati prej 5 (pesë) ditë nga data e shpalljes së këtij njoftimi.
6. Individët/familjet që nevojitet të plotësojnë, apo të përmirësojnë dokumentacionin e specifikuar në emrin e tyre, duhet ta paraqesin brenda një afati 5 ditë nga data e shpalljes së këtij njoftimi pranë zyrës me një ndalesë të Bashkisë Vlorë.

Në njoftimin publik të bazuar në Vendimin Nr.1, datë 15/01/2026 u shpallën listat përkatëse për personat e kualifikuar dhe të skualifikuar në fazën e dytë paraprake. Të gjithë personat e kualifikuar u njoftuan për të plotësuar dhe depozituar pranë Bashkisë Vlorë vërtetimet e marra nga ASHK me aplikim në portalin e-albania për të gjithë personat madhorë sipas çertifikatës familjare, se nuk disponojnë pronë të regjistruar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe nuk kanë kryer transaksion për tjetërsimin e pronësisë 5-vitet e fundit, brenda një afati 10 ditor.

Mbas përfundimit të kësaj faze Komisioni i Strehimit në mbledhjen e datës 18/02/2026 në vlerësim të të gjithë dokumentacionit të paraqitur nga familjet/individët të përcaktuar veçmas për çdo rast, mori vendimin, mbi të cilin është shpallur njoftimi publik në faqen e bashkisë, si vijon:


1. Listën përfundimtare të individëve/ familjeve të kualifikuar në fazën e dytë që përfitojnë nga programi social "Kredi me kushte lehtësuese", i financuar me fondet e buxhetit të shtetit. (renditja e tyre është kryer sipas rendit alfabetik) sipas tabelës nr. 1 bashkëlidhur njoftimit.
2. Listën përfundimtare të individëve/familjeve të kualifikuar në fazën paraprake të programit social "Kredi me kushte lehtësuese", i financuar me fondet e buxhetit të shtetit, por brenda afatit 10-ditor nga shpallja e këtij vendimi duhet të paraqesin vërtetim për secilin anëtar madhor të familjes, se nuk disponojnë pronë të regjistruar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe nuk kanë kryer transaksion për tjetërsimin e pronësisë 5-vitet e fundit, sipas tabela nr.1/1 bashkëlidhur njoftimit.
3. Listën e individëve/familjeve të kualifikuar mbas fazës së ankimimit, por brenda afatit 10-ditor nga shpallja e këtij vendimi duhet të paraqesin vërtetim për secilin anëtar madhor të familjes, se nuk disponojnë pronë të regjistruar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe nuk kanë kryer transaksion për tjetërsimin e pronësisë 5-vitet e fundit, sipas tabelës nr.2 bashkëlidhur njoftimit

4. Listën përfundimtare të individëve/familjeve të skualifikuar në fazën përfundimtare të programit social “Kredi me kushte lehtësuese nga buxheti i shtetit”, sipas tabelës nr.3 bashkëlidhur njoftimit.

Mbas plotësimit të këtij afati dhe depozitimit pranë Bashkisë të dokumentacionit të sipërcituar, për shkak të vonesave të portalit e-albania për gjenerimin e vërtetimeve të ASHK, Komisioni i Strehimit u mbledh në datën 13.03.2026. Komisioni bëri vlerësimin e të gjitha vërtetimeve për të gjithë anëtarët madhorë të familjeve se nuk disponojnë pronë të regjistruar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe nuk kanë kryer transaksion për tjetërsimin e pronësisë 5-vitet e fundit. Në fund të këtij procesi u vendos miratimi përfundimtar i listës së familjeve dhe individëve që kualifikohen dhe skualifikohen për të përfituar kredi me kushte lehtësuese nga shteti. Lista emërore e familjeve/individëve përfitues është objekt i këtij projektvendimi. Mbas miratimit nga Këshilli i Bashkisë Vlorë dhe shprehjes së ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut Vlorë, kjo listë do të përcillet në të tre bankat, me të cilat ka nënshkruar marrëveshjen ministria që mbulon çështjet e strehimit, Bankës Raiffeisen, Bankës Kombëtare Tregtare dhe Bankës Intesa Sanpaolo për të vazhduar me procedurat në kompetencë të tyre. Afati maksimal për kryerjen e procedurave të përfitimit të kredisë është 18 muaj nga data e protokollimit të listës emërore të përfituesëve pranë bankave.

**KRYETAR**

**Brunilda Mersini**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË  
KOMISIONI I STREHIMIT

Nr. 5708 prot.



VENDIM  
Nr. 5/1, datë 13.03.2026

**Për vlerësimin e dokumentacionit dhe kualifikimin e familjeve/individëve në listën përfundimtare të fazës së dytë të programit social “Kredi me kushte lehtësuese nga shteti”.**

Mbështetur në njoftimin publik të shpallur në faqen zyrtare të Bashkisë Vlorë në datën 25.02.2026 “Njoftim mbi shpalljen e listave përfundimtare të familjeve/individëve të kualifikuar dhe të skualifikuar në programin e kredive me kushte lehtësuese nga buxheti i shtetit”, mbi bazën e Vendimit të Komisionit të Strehimit të Bashkisë Vlorë Nr.5, datë 18.02.2026 “Për vlerësimin e dokumentacionit dhe kualifikimin e familjeve/individëve në listën përfundimtare të fazës së dytë të programit social “Kredi me kushte lehtësuese nga shteti”, me përmbajtje si vijon:

1. Lista përfundimtare e individëve/ familjeve të kualifikuar në fazën e dytë që përfitojnë nga programi social "Kredi me kushte lehtësuese", i financuar me fondet e buxhetit të shtetit. (renditja e tyre është kryer sipas rendit alfabetik). Tabela nr. 1 bashkëlidhur.
2. Lista përfundimtare e individëve/familjeve të kualifikuar në fazën paraprake të programit social "Kredi me kushte lehtësuese", i financuar me fondet e buxhetit të shtetit, por brenda afatit 10-ditor nga shpallja e këtij vendimi duhet të paraqesin vërtetim për secilin anëtar madhor të familjes, se nuk disponojnë pronë të regjistruar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe nuk kanë kryer transaksion për tjetërsimin e pronësisë 5-vitet e fundit. Tabela nr.1/1 bashkëlidhur.
3. Lista e individëve/familjeve të kualifikuar mbas fazës së ankimimit, por brenda afatit 10-ditor nga shpallja e këtij vendimi duhet të paraqesin vërtetim për secilin anëtar madhor të familjes, se nuk disponojnë pronë të regjistruar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe nuk kanë kryer transaksion për tjetërsimin e pronësisë 5-vitet e fundit. Tabela nr.2 bashkëlidhur.
4. Lista përfundimtare e individëve/familjeve të skualifikuar në fazën përfundimtare të programit social “Kredi me kushte lehtësuese nga buxheti i shtetit”. Tabela nr.3 bashkëlidhur,

Komisioni i Strehimit u mbledh në datën 13.03.2026 për të bërë vlerësimin e dokumentacionit të depozituar pranë Bashkisë Vlorë. Për shkak edhe të vonësave të portalit e-albania për gjenerimin e vërtetimeve të ASHK për të gjithë anëtarët madhorë të familjeve se nuk disponojnë pronë të regjistruar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe nuk kanë kryer transaksion për tjetërsimin e pronësisë 5-vitet e fundit, qytetarëve iu la afat deri në momentin e zbardhjes së këtij vendimi.

Sa me lart komisioni

VENDOSI:

1. Të miratojë listën emërore të familjeve/individëve, të cilët në përfundim të këtij procesi rezultojnë me përmbushjen e të gjitha kushteve dhe kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore për të përfituar banesë me kosto të ulët nëpërmjet kredisë me kushte lehtësuese nga shteti. Tabela nr.1 bashkëlidhur.
2. Të skualifikojë familjet/individët, të cilët në përfundim të procesit rezultojnë se nuk plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore për të përfituar kredi me kushte lehtësuese nga shteti. Tabela nr.2 bashkëlidhur.

KOMISIONI:

Irena Toshkallari

Kryetar

Kristaq Jorgaqi

anëtar

Mirela Mishgjoni

anëtar

Skerdilajd Hunda

anëtar

Orest Ruçaj

anëtar

Elidon Jaho

anëtar

Donald Leskaj

anëtar

Bledar Toja

anëtar

Genard Fegaj

anëtar

Kanan Shakaj

anëtar

Birçe Aliraj

anëtar

Drini Harizaj

anëtar

Drita Mustafai

anëtar